

VENDIM
Nr. 644, datë 5.11.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 110, DATË 19.2.2025,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR
KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2025”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, të vendimit nr. 110, datë 19.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 23, të kreut I, shtohet pika 24, me këtë përmbajtje:

“24. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit të Pronës Shtetërore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.”;

b) Në kreun II bëhen këto ndryshime:

i. pika 27 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“27. Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Ligjor, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;”;

ii. pika 33 shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama